

**PËR DELEGIMIN DHE DISA RREGULLA TË PËRFAQËSIMIT LIGJOR
TË MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të nenit 28, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 11, pika 2, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në proceset gjyqësore, kur thirret si palë në gjykim, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit/personave që do të përfaqësojnë ministrinë.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kur thirret si palë në gjykim, në proceset gjyqësore në të cilat objekti i padisë ka lidhje me institucionin e varësisë, lëshohen në emër të personit/personave që do të përfaqësojnë ministrinë nga drejtuesi i institucionit të varësisë, sipas vendit ku është ngritur kërkesëpadia.

3. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

4. Përfaqësimi për çdo proces gjyqësor bëhet nga juristë të Sektorit të Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, specialistë të fushës për të cilën është ngritur kërkesëpadia, si dhe përfaqësues nga institucionet e varësisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nëpërmjet autorizimit përkatës.

5. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në proceset gjyqësore, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesve të autorizuar të kryejnë çdo veprim procedural, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit.

6. Përfaqësuesit e caktuar të ndjekin me korrektësi seancat gjyqësore, për sa i takon pjesëmarrjes së tyre, e veçanërisht kontributit provues, paraqitjes së kërkesave, prapësimeve, pretendimeve, ankimeve, rekurseve, si dhe dokumenteve të tjera, që do të ndihmonin mbrojtjen e interesave të institucionit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

7. Në përfundim të proceseve gjyqësore, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda një afati 5-ditor nga shpallja/njoftimi i vendimit, të paraqitet informacion i detajuar, i shoqëruar (aty ky është e mundur) me vendimet përkatëse në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

8. Ngarkohen të gjitha institucionet e varësisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të caktojnë një person përgjegjës, që do të jetë pikë kontakti për të shkëmbyer çdo informacion të nevojshëm, si dhe njoftimin për ecurinë dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore, me Sektorin e Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

9. Ngarkohet Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit për vënien në dispozicion të dokumenteve të nevojshme, me qëllim paraqitjen e tyre konform ligjit, në cilësinë e provave materiale për proceset gjyqësore.

10. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, institucionet e varësisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2021

AUTORIZIM PËR PËRFAQËSIM NË ÇËSHTJEN GJYQËSORE

Në mbështetje të neneve 64–77 të Kodit Civil; të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile; të nenit 14, të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, dhe të urdhrit të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. _____, datë _____.____.____ “Për delegim dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”,

VENDOSA:

Autorizimin e _____ dhe _____, për të përfaqësuar Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, së bashku ose veç e veç, në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit, në çështjen gjyqësore, me palë ndërgjyqëse:

Paditës: _____

I paditur: _____

Objekti: _____

Përfaqësuesi ka të drejtë dhe tagra të nënshkruajë e depozitojë kërkesa, kërkesëpadi, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesa për pezullim dhe çdo akt të nevojshëm procedural para gjykatës, në përputhje me ligjin dhe në interesin e ligjshëm të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të cilën përfaqëson, deri sa vendimi të marrë formë të prerë e përfundimtare.

Autorizimi është i vlefshëm deri në përfundim të gjykimit në të gjitha shkallët e gjykimit, përveç rastit të nxjerrjes së një autorizimi tjetër nga ana e titullarëve me të drejtë firme.

(SEKRETARI I PËRGJITHSHËM/DREJTUESI I INSTITUCIONIT TË VARËSISË)